



01/Nr. 4953/2019
Data: 07.06.2019

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e pestë -V- për vitin 2019 e Komitetit për Politik dhe Financa, mbajtur me datë 21.05.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Sevime Laçi (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), Bashkim Sopa (Zyrtarë për Transparencë), Përfaqësuesi i OSB-së, Betime Bushi (Praktikante në Komunë). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politik dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i rishikimit të buxhetit të komunës për vitin 2019.
3. Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të rregullores për transparencë.
4. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimi e vendgjuetisë së përbashkët në territorin e komunës së Hanit të Elezit.
5. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i rishikimit të buxhetit të komunës për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- për rishikimin e buxhetit të komunës qeveria i përcakton afatet dhe e kemi proceduar për me pasur si pikë dhe po presim deri në mbledhje të kuvendit të komunës.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ish-in të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

U VOTUA RISHIKIMI I BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Shqyrtimi i plotësim ndryshimit të rregullores për transparencë.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Bashkim Sopa thekson:- rregullorja për transparencë është miratuar në vitin 2015 por gjatë vitit 2018 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka nxjerrë dy Udhëzime Administrative dhe atë Udhëzimi Administrativ 4/2018 për Transparencë Komunale dhe Udhëzimi Administrativ 6/2018 Standardet Minimale të Konsultimit Publik. Në vitin 2018 janë bërë ndryshimet e Statutit të Komunës dhe rregullorja që është në propozim duhet të harmonizohet me këto ndryshime. Te rregullorja e re që është në propozim sipas udhëzimeve administrative janë shtuar dy kapituj kapitulli i transparencës së buxhetit dhe kapitulli i prokurimit publik , si dhe është inkorporuar Udhëzimi Administrativ 01/2019 për përdorimin e pajisjeve teknologjike për transmetimin e seancave të kuvendit të komunës. Në përgjithësi janë obligimet e komunës që dalin për të qenë transparentë karshi komunitetit dhe harmonizimi me udhëzimet e reja administrative dhe ligjin për qasje në dokumentet publike. Kjo rregullore është harmonizuar me asociacionin e komunave, me zyrën e OSB-së dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe është arritur një pajtim që ky model i kësaj rregullore të jetë standard për të gjitha komunat për shkak të vlerësimeve që ju bëhen komunave. Modeli është i njëjtë që do të aplikohet në të gjitha komunat e Kosovës

Mehmet Ballazhi thekson:- duke u bazuar në gabimet e tepërta gjuhësore, ortografike brenda materialit nuk të jep shumë mundësi atraktive për me lexuar. Unë mendoj që kjo rregullore të procedohet për një mbledhje tjetër dhe të rishikohet, të përmirësohet dhe të përpunohet me persona pak më profesional dhe të koordinohet me zbatimin e pikave që i parashihen në rregulloren për transparencë dhe pastaj të na dërgohet si dokument. Ka shumë pika që nuk përputhen dhe nuk gjejnë zbatim në praktikë edhe nga gabimet e tjera. A ka diçka që ju keni propozuar vetë apo nga kush është propozuar ? Faqe tre pika 8 a zbatohen vendimet e kuvendit për transmetim të mbledhjeve të kuvendit të komunës që parashihen në këtë rregullore sepse kuvendi ka marr vendim për transmetimin e seancave të kuvendit të komunës. Sa janë publikuar pakënaqësitë dhe shqetësimet e qytetarëve për punimet në projektet e ndryshme të cilat nuk janë kryer me përgjegjësi, se ka shumë ankesa të shumta dhe këtu në rregullore parashihet që komuna duhet të ketë transparencë gjatë dëgjimeve publike për projekte dhe çështje të tjera sidomos nëpër fshatra. Faqe shtatë pika 1.6 të gjitha dokumentet e tjera për të cilat komuna vlerëson se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik por mendoj që duhet të ketë një qartësim më të mirë për shkak se komuna nënkupton diçka më shumë. Neni 12 pika 1.1 publikimet dalin edhe në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë të integruar si vegeze në web-faqen zyrtare të komunës kërkoj sqarim. Neni 14 është shënuar pika një pika një dhe dyshi mungon. Rregullorja për Transparencë duhet të jetë transparente edhe në zbatim sepse po të shikohen nenet të cilat janë përcaktuar duket që nuk ka zbatim. Sipas pikës katër të nenit 14 cilat janë ato projekte që janë miratuar sipas konsultimeve publike që janë paraqitur në dëgjime publike dhe janë marr konsultat nga dëgjimet publike dhe ju i keni zbatuar në teren. Cilat janë projektet të cilat i keni publikuar që nuk kanë gjetur zbatim dhe përkrahje në teren apo kanë gjetur të gjitha por nuk ka diçka që është specifikuar për ndonjë projekt të caktuar. Për projekte të ndryshme ka në teren sepse komuna asnjëherë nuk na ka pyetur se a po e doni këtë projekt apo nuk po e doni , a keni ndonjë ide për këtë projekt apo nuk keni. Ka shumë paqartësi nëpër pika dhe propozoj që kjo pikë të kthehet edhe një herë te propozuesi, të përpunohet mirë të hiqen shumica e gabimeve që janë dhe të procedohet pastaj.

Mallzum Qajani thekson:- është e vërtetë që dokumentet që trajtohen nëpër organe të tjera kanë gabime teknike dhe këto gabime do të na përcjellin për arsye se nuk i nënshtrohet një kontrollit profesional i cili do t'i rregullonte gabimet teknike dhe gjuhësore . Për këtë dokument mund të kemi pa qartësi por nëse ka ndonjë propozim që do të ndërron përmbajtjen e cilit do nen apo pikë dhe nëse nuk ka ne mund ta marrim si obligim për me përmirësuar gabimet teknike të rregullores dhe rregullorja të përcillet për kuvend. Vërejtje patë te faqja shtatë te pika shtatë por realisht të flasim ka dokumente që nuk i nënshtrohen konsultimit publik por ka

dokumente që nuk i nënshtrohen sepse krijon konflikt në publik dhe ato vlerëson komuna se një dokument është i ndjeshëm për publikun apo nuk është i ndjeshëm për publikun . Nëse një dokument për një kohë të caktuar është i ndjeshëm për publikun nuk e publikon në atë periudhë dhe mund ta publikon në periudhën e më vonshme. Në vitin e kaluar kam marr pjesë në dëgjimet publike dhe ato mbahen në secilin fshat dhe më në fund mbahen në Han të Elezit. Në disa fshatra janë të pa interesuar për me marr pjesë kurse në Han të Elezit merr pjesë një numër i kufizuar dhe nuk merrni pjesë as ju këshilltarët. Dëgjimet publike janë që me shprehur interesimin e juaj për projektet e ndryshme dhe në komunën mbahen shtatë apo tetë dëgjime publike dhe sa qytetarët janë të interesuar me propozuar projekte është tjetër problem. Projektet të cilat i realizon komuna kalojnë përmes dëgjimeve publike të kuvendit dhe nuk ke drejtë me potencuar për shkak se secili vendim që realizohet kalon nëpër kuvend. Nuk mund të potenconi që komuna realizon projekte krye në vetë sepse nuk realizon.

Mehmet Ballazhi thekson:- të drejtë me potencuar kam çdo herë për shkak se ti nuk mundesh me ma mohuar të drejtën me potencuar diçka . Ti a donë me mohuar të drejtën që mos me potencuar që komuna realizon diçka në krye në veti unë mendoj që duhet të jeni pak më të qartë. Unë potencova pikën 1.6 në faqe shtatë dhe nuk është patjetër me arsyetuar këtë dhe unë jam një anëtarë i kuvendit dhe mendoj kësisoj dhe nuk do të thotë që me ma ndaluar atë që me shprehur që nuk bënë me përcjell por janë edhe katër anëtarë të KPF-së që kam me ngrit dorën dhe e kanë të drejtë e shprehjes dhe mospajtimit dhe nuk keni të drejtë të ma potenconi këtë. U potencua që nuk marrin pjesë këshilltarët nëpër dëgjime publike por ne po marrim pjesë edhe në KPF dhe në kuvendin e komunës dhe askush nuk po na vetë për këtë punë dhe as nuk e marrin mendimin tonë sikur tash që po insistojnë dhe potencojnë që nuk ke drejtë me fol dhe është e njëjta në kuvend dhe kështu ua bëni edhe qytetarëve. Ka projekte të cilat janë kryer pa miratimin e qytetarëve qoftë të një vendbanimi edhe pse ju kanë sugjeruar dhe këshilluar por e keni kryer pa miratimin e tyre dhe për atë potencova që në këtë rregullore bie ndesh me veprimin në teren. Komuna nuk e ka zbatuar vendimin i cili është marr në kuvendin e komunës për transmetimin e seancave të kuvendit të komunës.

Bashkim Sopa thekson:- është përdorë termi vegza linqe për me i ikur terminologjisë Angleze e kam përdorë fjalën vegzë. Dokumenti është produkt i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Asociacionin e Komunave dhe brendësia qëndron në baza ligjore dhe nuk mundemi me kontestuar dhe nuk mundemi me i ikur asaj që del si obligim prej një Udhëzimi Administrativ. Shkaku i ndryshimeve qëndron për shkak obligimeve që dalin prej dy Udhëzimeve Administrative. Për transmetimin e seancave është Udhëzimi Administrative 01/2019 dhe me asnjë dokument që është aktualisht në Kosovë nuk obligohet komuna me transmetuar medime përveç se në faqen zyrtare të komunës sepse është e rregulluar me udhëzim administrativ. Në cilësi të shërbyesit civil jam i obliguar me zbatuar udhëzimin administrativ dhe po më vjen shumë keq që çështja e transmetimit të seancave po lidhet me mu dhe nuk ka të bëjë me mua dhe nuk është në mandatin tim por unë jam i obliguar me zbatuar udhëzimin administrativ po më vjen keq se qe një vit është bërë polemikë dhe ky problem adresohet te unë dhe nuk ka të bëjë me mua se unë jam shërbyes civil dhe e zbatoj udhëzimin administrativ. Sa i përket zbatimit të kësaj rregullore unë them që kjo rregullore ende nuk ka hyrë në fuqi dhe nuk mundemi me fol për efektin e kësaj rregullore për të shkuarën por të flasim për efektin e kësaj rregullore për të ardhmen. Në qoftë se rregullorja miratohet në kuvend pas një viti e kanë të drejtën këshilltarët me parashtruar pyetje se sa është zbatuar kjo rregullore. Shumë elemente të kësaj rregullore janë duke u diskutuar se a janë të arsyeshme dhe të aplikueshme dhe nuk mund të flasim për efektin e kësaj rregullore ende pa u miratuar dhe pa hy në fuqi. Këto janë të nxjerrura prej udhëzimit administrativ dhe nuk të lenë hapësirë për me i ndryshuar sepse janë të thirrura në ligje dhe statutin e komunës dhe në koordinim me Ministrinë e Administrimit të pushtetit Lokal dhe Asociacionit të Komunave.

Nuriman Kuka thekson:- a keni ndonjë pikë që duhet me u shtuar në rregullore dhe nëse ka atëherë duhet plotësohet dhe përpunohet dhe nëse jeni për me proceduar për ndonjë mbledhje të radhës ne mundemi po sa po ka pasoja pastaj?

Mehmet Ballazhi thekson:- unë mendoj që rregullorja mos të procedohet por të përpunohet dhe të përcillet për mbledhje të radhës sepse unë i përcjella shqetësimet e mia por edhe ju i keni shqetësimet e juaja dhe kjo rregullore nuk është vetëm për mu por është për të gjithë qytetarët e komunës së Hanit të Elezit por edhe nëse shkon në këtë mënyrë mua personalisht nuk më pengon , mirëpo niveli i realizimit dhe i përmbajtjes nuk është për qytetarët. U potencua nga z.Bashkim Sopa që nuk ka filluar me u zbatuar kjo rregullore por unë mendoj që 70 % e i pikave janë të rregullores paraprake dhe do të thotë që një rregullore është zbatim se po e kuptoj që është draft për momentin. Në bazë të asaj rregullore shumica e pikave janë inkorporuar në këtë rregullore dhe për atë po flasim. Cilat janë pikat ma kyçe që ju i keni propozuar me u plotësuar dhe me u ndryshuar që ju i keni paraparë që në rregulloren e kaluar nuk kanë funksionuar dhe për atë e keni bërë për ndryshim. Është dashur të hijezohen ndryshimet të cilat i keni bërë në mënyrë që me pas më lehtë ne si këshilltarë.

Bashkim Sopa thekson:- është neni 19 që ka të bëjë me transparencën financiare dhe neni 20 transparenca në aktivitetet e prokurimit si kaptina që ju kanë shtuar rregullores së vjetër dhe janë shtuar elemente të Udhëzimit Administrativ 06/2018 ku ndërrohet metodologjia e konsultimeve publike e që sipas këtij udhëzimi formon standarde të tjera të konsultimit me publikun.

Kryesuesi thekson:- në qoftë se rregullorja është në kundërshtim me ligjin nuk do ta procedojmë për shqyrtim dhe miratim në kuvend dhe nëse përmbajtja është në rregull për gabime që janë mund të përmirësohen dhe procedohen. Është mirë të konsultoheni me zyrtarin ligjorë për çështjen e renditjes së neneve. Nëse ka ndonjë arsye të fortë mund ta kthejmë por për gabime teknike nuk e kemi kthyer asnjë herë ndonjë material. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 4 për, 1 kundër (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

U VOTUA PLOTSIM NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR TRANSPARENCË QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët në territorin e komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- shoqata e gjahtarëve ekziston në Han të Elezit dhe ka funksionuar me disa udhëzime dhe leje por gjitha komunat kanë shpallur vendgjueti të përbashkët dhe në territorin e Hanit të Elezit kemi paraparë që të jetë me një vend. Me datë 08.04.2019 kemi përcjellë shkresën në Ministri të Bujqësisë për dhënie të pëlqimit. Me datë 25.04. 2019 pëlqimi është lëshuar nga Ministria e Bujqësisë. Pasi të merret vendimi në kuvend duhet të shpallet tenderi për vendgjueti të përbashkët dhe mund të konkurrojnë shoqatat e gjahtarëve.

Kryesuesi thekson:- te neni dy është shënuar vendgjahishta dhe unë mendoj që më mirë është të shënohet vendgjueti. A kemi mundësi dy apo tri vendgjueti të përbashkët dhe nëse është vetëm një vendgjueti kërkoj sqarim?

Zaim Bela thekson:- territori i Hanit të Elezit i ka 8300 hektarë dhe një vendgjuetia duhet ti ketë mbi 1000 hektarë. Kemi mundur me i bërë dy vendgjuetie por duhet të shpallen dy procedura të tenderimit por edhe komunat të cilat kanë pasur më shumë hektarë se na e kanë bërë një vendgjuetie.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E VENDGJUIETISË SË PËRBASHKËT PËR TERRITORIN E HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- në fillim kemi dhënë një vlerësim për ndotjen në mjedis dhe cilësinë e ajrit e cila vitin e kaluar ka qenë jo e mirë kryesisht për shkak të punimeve të “Bektelenkës”. Burim ndotës si zakonisht ka qenë “Sharrcemi” dhe qarkullimi i madh i veturave. I kam paraqitur rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit nga stacioni i monitorimit të ajrit që është te shkolla fillore. Nga viti i kaluar qytetarët përmes linqeve kanë mundësi drejtë përdrejtë onllajn me u informuar për ndotjen dhe rreth cilësisë së ajrit në Han të Elezit. Është edhe tabela e cilësisë së ajrit sipas udhëzimit administrativ gjashtë parametrat të cilat kërkohen në bazë të ligjit dhe monitorohen në bazë të standardit evropian. Në vitin 2018 janë regjistruar tejkalime të shpeshta të vlerës së lejuar afër 148 ditë. Informatës ia kam përcjellë edhe raportin e kompanisë “Sharrcem” për mjedisin. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Teuta Shkreta thekson:- në takimet që keni pasur me kompaninë “Sharrcem” a është bërë ndonjë trysni së paku për vitet e tjera për çështje të ndotjes

Nexhmedin Daci thekson:-për çdo muaj jemi në kontakt me zyrtarin për mjedis të kompanisë “Sharrcem” dhe i përcjell për çdo muaj sepse e kanë obligim në bazë të lejes mjedisore. Nuk kanë qëndrim të drejtë ato ndaj këtij problemi dhe hallën e klinkerit e kanë paralajmëruar por punimet i kanë zhegatur dhe ende nuk i kanë përfunduar. Retro materialet i mbanë në sipërfaqe të hapura dhe sipas lejes së integruar duhet t’i mbanë në ambient të mbyllur, mirëpo ne nuk kemi kurfarë kompetencë në “Sharrcem” lidhur me këto për shkak se ministria i përcjell.

Kryesuesi thekson:- kundërmon erë e rëndë e sulfurit dhe shpesh ndodhë kjo.

Nexhmedin Daci thekson:- materialet të cilat i përdorin janë inorganike por një përqindje të lëndës djegëse e përdorin mazutin dhe ka mundësi me qenë jo cilësorë dhe me përmbajtje mbi 3% sulfur por nuk e pranojnë dhe ne nuk mundemi me konstatuar.

Nora Xhoni thekson:- shifrat nuk janë të sakta që epen prej kompanisë “Sharrcem”

Mehmet Ballazhi thekson:- në informatë është shënuar ndotja e tokës dhe e ujit edhe më shumë të dëmshme janë mbetjet e azbestit të cilët janë në lumin Lepenc . Projekti ka qenë nga inistria pavarësisht punës që ka bërë ende ka mbetje të azbestit. Ndotja e ujit të lumit Lepenc është shqetësuese nga mbeturinat e pa trajtuara të sistemit të ujërave të zeza e kombinuar me ndotjen kimike nga industrinë në këtë regjion . A keni bërë ndonjë bashkëpunim me regjionin për këtë çështje?

Nexhmedin Daci thekson:- me çështje të ujërave të zeza edhe Bashkimi Evropian është duke u interesuar për çështje të ndërtimit të impianteve .

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

U VOTUA INFORMATA MBI MBROJTJEN E MJEDISIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.


Mehmet Ballazhi thekson:- a janë duke u zhvilluar punimet te fusha e futbollit?

Nexhmedin Daci thekson:- punimet janë duke vazhduar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen, ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:14

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

